

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Burim Shala, kryetar i kolegjit, Ramë Hyseni dhe Gani Avdiu anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve : A. dhe B.P., nga fsh. ..., Komuna e Podujevës të cilët i përfaqëson H.P., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H.K., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2087/09 të datës 19.09.2014, pas mbajtjes të seancës së kolegjit, më datë 02.07.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e paditësit B.P. nga fshati ..., Komuna e Podujevës dhe e paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** pjesa e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2087/2009 i datës 19.09.2014 për pjesën gjyquese për paditësin B.P..

II.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit A. P. nga fshati ..., Komuna e Podujevës dhe e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë **VËRTETOHET**, pjesa e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2087/2009 i datës 19.09.2014, sa i përket pjesës gjyquese për dëmin material për paditësin A. P.

III. Pjesërisht **APROVOHET** ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe **NDRYSHOHET** pjesërisht, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2087/2009 ashtu që gjykohet si në vijim **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. P. nga fshati ..., Komuna e Podujevës dhe **detyrohet** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve që për shkak të lëndimeve e lehta trupore që i ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit të datës 08.07.2009 të ia kompensoj atij : në emër të dëmit jo material : për dhimbje fizike shumë prej 1400 euro, për frikën e pësuar shumë prej 1100 euro , për shëmtim shumë prej 1200 euro, me kamat ashtu siç paguajnë Bankat në Kosovë kursimtarëve të tyre në mjetet e deponuara mbi një vit nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë më datë 19.09.2014 e deri në pagesën përfundimtare.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit A. P. mbi shumën e gjykuar si në pikën III të këtij aktgjykimi Refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.2087/09 të datës 19.09.2014, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në vijim: “Në pikën I (një) të dispozitivit, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve A. dhe B.P. nga fsh. ..., Komuna e Podujevës si të bazuar, dhe ka detyruar të paditurën KS “Illyria” me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jo material të paguaj si vijon : Për dëmin Jo Material paditësit B.P. : në emër të dhimbjeve trupore-fizike, shumën prej 3400,00€,për frikën e pësuar shumën prej 2,700,00€, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1,750,00€,për shëmtim trupor shumën prej 1,200,00 €. Për Dëmtim Material : për ushqim të përforcuar, shumën 80,00€, për ndihmën dhe kujdesin nga tjetri shumën 85,00€, për shpenzime të shërimit shumën 202,00€. Paditësin A. P. për Dëmin Jo Material : për dhimbjet e përjetuara fizike 1.800,00€, për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 2,500,00€, për shëmtim trupor shumën prej 1.600,00€. Për Dëmin Material : për ushqim të përforcuar shumën prej 40,00€, për ndihmën dhe kujdesin nga tjetri shumën prej 30,00€ dhe për shpenzimet e shërimit shumën prej 24,00€. Po ashtu detyrohet e paditura që paditësve, t’jua paguaj edhe kamatën, sipas mjeteve të deponuara në bankën pa distininim të caktuar mbi një vit nga data e precizimit, dt.23.09.2010 si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën 1.866,00€. Në pikën e II (dytë) të dispozitivit e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve përtej shumës së gjykuar dhe atë : për paditësin B.P., për dhimbje fizike mbi shumën 3.400,00€ e deri në shumën 6.000,00€, për frikën mbi shumën 2.700,00€ e deri në shumën 3.000,00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor mbi shumën 1750,00€ e deri në shumën 7.000,00€, për shëmtim mbi shumën 1.200,00€ deri në shumën 2.000,00€ , për ushqim të përforcuar mbi shumën 80,00€ e deri në shumën 300,00€ , për ndihmën dhe kujdesin nga tjetri mbi shumën 85,00€ e deri në shumën 150,00€ , për shpenzimet të shërimit mbi shumën 202,00€ deri në shumën 242,00€ , për rehabilitim klimatik shumën 1.000,00€ , për zvogëlim të aktivitetit punues shumën 6.000,00€, kurse për paditësin A. P., për dhimbje fizike mbi shumën 1.800,00€ deri në shumën 4.000,00€ , për frikën mbi shumën 2.500,00€ e deri në shumën 3.000,00€, për shëmtim trupor mbi shumën 1.600,00€ e deri në shumën 2.000,00€ , për ushqim të përforcuar mbi shumën 40,00€ deri në shumën 150,00€ , për ndihmën dhe kujdesin nga tjetri mbi shumën 30,00€ deri në shumën 80,00€, për rehabilitim klimatik shumën 150,00€ si dhe për kamatë, për periudhën deri në precizim me dt.23.09.2010

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë parashtruar ankesë paditësit Bajram dhe A. P. për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve, dhe e paditura K.S. “Illyria” për shkak të Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i ankimuar të Prishet dhe çështja ti kthehet në Rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së gjeti se :

Ankesa e paditësve B.P. dhe A. P. nga fshati ..., Komuna e Podujevës është e pabazuar ndërsa ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria" me seli në Prishtinë është pjesërisht bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, më datën 11.09.2009, përmes të autorizuarit të tyre H.P. avokat nga Prishtina, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi për kompensimin e dëmit kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria" me seli në Prishtinë, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kompensojë dëmit material dhe jo material që i është shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 08.07.2009.

Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat si: raporti i Policisë i dt.08.07.2009 lidhur me aksidentin; raporti i Qendrës Emergjente në Prishtinë i dt. 08.07.2009 nr.20884 për B.P.; raporti i Qendrës Emergjente në Prishtinë për A. Podvoricës i dt.08.07.2009 me nr.20874; raporti i mjekut specialist Dr. B.B. i dt.14.07.2009; mendimi i ekspertit nga lëmia e ortopedisë dhe traumatologjisë Dr. Xh.S. i dhënë në seancën e dt.22.09.2010 dhe mendimi i ekspertit të neuropsikiatrisë Dr.F.D. i dhënë më dt.19.09.2014, nga këto prova gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet se ndërmjet ndërgjyqësve nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë, dhe se aksidenti është shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës K.H.K. por kontestuese ka qenë lartësia e kërkesëpadsisë. Nga mendimi i ekspertit të ortopedisë Dr. Xh.S. dhe eksperti i psikiatrisë Dr. F.D. gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se paditësi i parë B.P. në aksidentin e trafikut ka pësuar ndrydhje me plagë prerëse, gërvishtëse në regjionin e hundës dhe në buzën e sipërme, përdredhje të qafës dhe ndrydhje të gjurit të majtë me lëndim të brendshëm të kapsulës dhe menisqeve, të cilat lëndime i ka karakterizuar si lëndime të rënda trupore. Si rezultat i këtyre lëndimeve ai ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 40 minuta, të intensitetit të rëndë 24 orë, të intensitetit të mesëm 40 ditë, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët ka pasur edhe gjatë kohës kur është nxjerr ekspertiza gjatë forcimeve fizike, ngjitjes dhe zbritjes në shkallë. Paditësit të parë si rezultat i lëndimeve të rënda të pësuar në aksidentin e komunikacionit i është zvogëluar edhe aktivitetit i përgjithshëm jetësor në shkallën prej 5 % për shkak të dëmtimit të menisqeve dhe pengesave të kohë pas kohëshme në gjurin e majtë si dhe shëmtim të shkallës së lehët për shkak të një varje në buzën e sipërme e cila është e dukshme në gjatësinë prej 1cm, po ashtu ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 3 javë dhe për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë për 14 ditë, po ashtu edhe shpenzime të shërimit për shkak të vizitave mjekësore dhe blerjes së barërave. Paditësi i parë ka përjetuar edhe frikë primare për disa sekonda , frikë sekondare të intensitetit mesatar 3 orë, frikë sekondare të intensitetit të ulët 3 muaj.

Paditësi i dytë A. P. në aksidenti i trafikut ka pësuar lëndime, ndrydhje të kraharorit, të cilat lëndime janë karakterizuar si lëndime të lehta trupore. Si rezultat i këtyre lëndimeve ai ka pësuar : dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 15 minuta, të intensitetit të rëndë 6 orë, të intensitetit të mesëm 5 ditë, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët ka pasur për rreth 14 ditë ; frikë primare për disa sekonda për shkak të deformimit të auto-veturës dhe mos hapjes së derës së veturës nga ana e ti e që deri te hapja e derës ka zgjatë disa minuta dhe duke llogaritur moshën e tij 18 vjeçare, përpjekjet për ta shmangur aksidentin, pamundësia me dal shpejt nga vetura, si dhe të menduarit se vetura mund të ndizet ; frikë sekondare e intensitetit të lartë e cila ka zgjatë 2 orë dhe është manifestuar me procedura të diagnostikimit mjekësor; frikë sekondare të intensitetit mesatar dhe të ulët e cila ka zgjatë për një (1) muaj, që është e shoqëruar me shqetësime dhe kur ka biseduar rreth rastit dhe ka kaluar pranë vendin ku ka qenë i shkaktuar aksidenti; ka pësuar shëmtim trupor të shkallës së lehtë për shkak të një varje në buzën e sipërme e cila është e dukshme në gjatësi rreth 1cm; ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 10 javë; ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin nga personi i tjetër për 5 ditë (duke e marrë për bazë mendimin e ekspertit mjekësor të ortopedisë dhe traumatologjisë); iu është nënshtruar vizitave mjekësore dhe blerjes së barërave (në bazë të faturave të cilat i ka dorëzuar me precizim); ka pasur nevojë për rehabilitim klimatik (edhe pse në bazë të ekspertit mjekësor të ortopedisë dhe traumatologjisë paditësi A. P. ka pasur nevojë për rehabilitim fizioterapeutik, dy herë nga 5 ditë në vitin e parë të aksidentit-kjo sepse paditësi nuk i ka dorëzuar gjykatës asnjë pro-faturë)

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit Jo Material dhe Material për secilin veç e veç ka vendosur sipas vlerësimit të lirë, praktikës gjyqësore, mendimin e ekspertëve mjekësorë Dr. Xh.S. - Ortoped dhe Traumatolog dhe Dr. F.D. – Neuropsikiatër të cilat ekspertiza, gjykata e shkallës së parë i vlerësoi si profesionale dhe të paanshme, pastaj ka marr për bazë edhe moshën dhe gjininë e paditësit B.P. (1959), moshën dhe gjininë e paditësit A. P. (1991). Kështu, gjykata e shkallës së parë në rastin konkret është mbështetur në aplikimin e dispozitave nga neni 154, 155, 178 dhe 200 të LMD-së, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vlerëson përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe vëren se Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), m) të LPK-së për të cila shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare e po ashtu gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar lartësinë e kërkesëpadisë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike, frikën e pësuar dhe për shëmtim trupor për paditësin e dytë A. P. dhe për këtë aktgjykimi pjesërisht u ndryshua dhe u gjykua si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet e ankimore të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit në këtë rast nuk ka qenë kontestuese. Gjendjen faktike për dëmin Jo Material dhe për dëmin Material në formë të ndihmës dhe kujdesit të huaj dhe ushqimit të përforcuar gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertëve Dr. Xh.S. dhe Dr. F.D.. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit të parë B.P. dhe të paditurës K.S. Illyria, për sa i përket lartësisë së shumave të gjykuara për paditësin B.P.. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar shumat për dëmin Jo Material për paditësin e parë B.P.. Paditësi i parë ka pësuar lëndime të rënda trupore ndërsa paditësi i dytë ka pësuar lëndime të lehta trupore duke përjetuar dhimbje fizike, frikë primare dhe sekondare, ku paditësi i parë si rezultat i lëndimeve të rënda i është zvogëluar aktivitetit jetësor në shkallën prej 5% e po ashtu ka pësuar edhe shëmtim të shkallës së lehtë. Mbi bazë të kësaj Gjykata e Apelit, vlerëson se shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, për format e dëmit Jo Material janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e kompensimit të dëmit të përcaktuar me nenin 200 të LMD-së, këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 200 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar: “Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtati synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara, shkallën e shëmtimit dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor si dhe kohë zgjatjen dhe intensitetin e frikës, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit, që në këtë rast paditësi i parë i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit. Shumat e gjykuara janë reale dhe paraqesin satisfaksion të vërtetë dhe u shkojnë për shtati synimeve dhe qëllimit shoqëror për kompensimin e dëmit.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë : natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës si dhe rrethanat tjera, mosha e paditësve, praktika gjyqësore rezulton se shumat e gjykuara për paditësin e parë janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që kanë pësuar paditësi B.P., duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin B.P., duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Janë të pa bazuara pretendimet ankimore të paditësit B.P., gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për dëmin material për rehabilitim klimatik. Paditësi i parë nuk ka ofruar prova për ta vërtetuar faktin se së pari ka shfrytëzuar shërimin klimatik por edhe lartësinë e shpenzimeve për këtë formë të dëmit material.

Lidhur me shumat e gjykuara për paditësit që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material në emër të përkujdesjes së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme duke marrë për bazë kohëzgjatjen nevojës për përkujdesjen e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore për secilin nga paditësit si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh raste të tilla të kompensimit.

Duhet të vlerësohet fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshin ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo pasi që paditësit kanë pasur nevojë për ndihmë e huaj dhe ushqim të përforcuar (të konstatuar në ekspertizë për secilin nga paditëset), të njëjtëve ligjërisht u takon ky lloji dëmi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vet kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se censorët e tyre në rastet e aksidenteve të komunikacioneve të dëmtuarve jua njohin deri në 100€ në muaj për ushqim të përforcuar, 100€ në muaj për kujdes nga personi i tretë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të paditurës dhe të paditësit të dytë A. P. për sa i përket pjesës gjyqësore për paditësin e dytë dhe gjeti se pretendimet ankimore të paditurës janë pjesërisht të bazuara ndërsa pretendimet e paditësit të dytë janë të pabazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gabimisht është zbatuar e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë kur janë gjykuar shumat për shëmtim, dhimbje fizike dhe për frikën e përjetuar të paditësit të dytë A. P. në lartësinë si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë pasi që shumat janë të larta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin. Prandaj gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës ndryshoi pjesërisht aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket pjesës gjykuese për paditësin e dytë A. P. për dëmin jo material dhe gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material për shëmtim, dhimbje fizike dhe për frikën e pësuar nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës, për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e së mirës së dëmtuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), e) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË

Ac.nr. 4898/14 datë 09.07.2018

Kryetari i kolegjit,

Burim Shala d.v.